



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 85/6 prot.

Tiranë, më 21.2.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Çela
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 6.2.2023, është njoftuar vendimi nr. 595, datë 7.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Çela, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 6.2.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë Komisioneri Publik, Irena Nino, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, datë 6.2.2023, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Arbër Çela, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Çela, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e tri kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Arbër Çela”², ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Arbër Çela, nr.*** prot., datë **.11.2017, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër *** Çela”. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, DSIK, me anë të raportit nr.*** prot., datë **.5.2022³, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit: “Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër *** Çela”.

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela.

3. Përfundimet e Komisionit, për secilin kriter, kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. [...] trupi gjykues vlerëson se në analizën që i bën situatës faktike për llogari të procesit të rivlerësimit: kualifikimin ligjor të shtetases ***,***, si bashkinvestitore në pasurinë apartament me sipërfaqe 91.91 m², në rrugën “***”, Tiranë, blerë me Kontratë Porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2013; mundësitë financiare të shtetasit ***,***, për huadhënien, e cila është zëvendësuar në vijim brenda vitit kalendarik me kredinë bankare, mbajtur në konsideratë edhe trajtimin ligjor prej Kolegjit në raste të ngjashme⁵, vlerëson se pasuria e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela është krijuar në mënyrë të ligjshme dhe nuk ka mungesë burimesh financiare të ligjshme. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen këtë pasuri, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, të besueshme e me burime financiare të ligjshme⁶.

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.1.2018.

³ Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr.***, datë **.5.2022.

⁴ Raport i KLGJ-së nr. ***/** prot., datë **.2.2020.

⁵ Shihni vendimin (JR) nr. 14, datë 15.6.2021 dhe vendimin nr. 38, datë 24.10.2022, të Kolegjit.

⁶ Referohuni f. 51-52 të vendimit të Komisionit.

Trupi gjykues, pasi vlerësoi marrëdhënien pasurore të deklaruar nga subjekti, e analizoi atë në tërësi, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se pasuria e subjektit të rivlerësimit rezulton të jetë e ligjshme dhe se nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Për rrjedhojë, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016⁷ [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] *Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kontakti i deklaruar prej tij nuk u gjet në kushtet e përcaktuara në kreun V të ligjit nr.84/2016 dhe as i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion vlerësues negativ për këtë subjekt. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...]*⁸.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] *se disa prej gjetjeve përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, përpos gjetjeve që u konstatuan të pambështetura në ligj dhe fakte, sipas vlerësimit të trupit gjykues. Disa nga gjetjet e konstatuara janë të tilla që nuk mjaftonin për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si nën nivelin minimal kualifikues, për pasojë, në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për efekt të këtij procesi, në kuptim të zbatimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 [...]*⁹.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër [...].*

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”¹⁰ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2¹¹ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 6.2.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë aktin me nr. prot. 61/1 “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Arbër Çela (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Në mënyrë të përmbledhur, ONM konstaton se lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë: (i) Ka elemente që të bëjnë të besosh mbi ekzistencën e më tepër se një dyshimi të arsyeshëm për fshehje të pasurisë “apartment me sip. 91,92 m²”, në rrugën “***”, nëpërmjet bashkëpronares ***.*** dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të kundërshtonte barrën e

⁷ Referohuni f. 22 të vendimit të Komisionit.

⁸ Referohuni f. 37-38 të vendimit.

⁹ Referohuni f. 52 të vendimit.

¹⁰ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

¹¹ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

provës lidhur me këto dyshime lidhur me: (I) Mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit në shumën 7.304.299 lekë, për të financuar kontributin faktik për pasurinë *apartment me sip. 91,92 m²* ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për shkak të: (2) Mungesës së burimeve të ligjshme të bashkëpronares ****.*** për investimin e përbashkët në apartamentin me sipërfaqe 91.9 m² ndodhur në rrugën “****”, Tiranë; (ii) Mungesës së burimeve të ligjshme të huadhënësit ****.*** për t’i dhënë subjektit të rivlerësimit huan prej 30.000 euro, e përdorur si një nga burimet për blerjen e apartamentit nga subjekti¹².

6.1 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, ONM në rekomandim ka vlerësuar të ndalet veçanërisht në analizën e dy çështjeve: (i) Çështja në lidhje me të pandehurin ****.***, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. ****, datë **.2.2019; (ii) Ankesa/denoncimi i bërë nga shtetasja, znj. ****.***, në lidhje me rastin e paditësit ****.***, me objekt: “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.***, të vitit 2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Shkodër”, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. **** (***), datë **.12.2014; (iii) Çështjet e trajtuara si gjetje në vendimin e Komisionit¹³.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, çmon se ai është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: (i) rezultatet e hetimit mbi kontrollin e kriterit të pasurisë; (ii) rezultatet e hetimit mbi vlerësimin profesional dhe ato të dala si gjetje në kontrollin e figurës.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 595, datë 7.12.2022, të Komisionit.

¹² Referohuni f. 2-3 të aktit “Rekomandim i ONM-së”.

¹³ Referohuni f. 12-13 të aktit “Rekomandim i ONM-së”.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A Kontrolli i pasurisë

12. Lidhur me rivlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka në vëmendje se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

13. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Arbër Çela, është bërë subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2010 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave privatë periodikë për vitet 2010 - 2016 (në vijim DV -20--) dhe në datën **.1.2016 ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, trajtohet pasuria shkak ankimi bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 6.2.2023.

15. Pasuria “Apartament me sipërfaqe 91,91 m²”, ndodhur në rrugën “**”, Tiranë**

15.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sipërfaqe 91,91 m², Rr. “****” (rrugica ***), Tiranë¹⁴. Burimi i krijimit: (i) 30.000 euro sipas kontratës së kredisë bankare nr. *** rep., nr. ***/** kol., datë **.9.2013; (ii) 4.000 euro, dhuratë nga prindërit¹⁵; (iii) Kursimet personale. Vlera totale: 73.528 euro. Vlera e pjesës time 50%: 36.764 euro. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me shtetasen ***.***¹⁶.

15.1.1 Në të njëjtën deklaratë në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Kontratë kredie nga Banka e *** sh.a., datë **.9.2013, për blerjen e apartamentit, në shumën 30.000 euro, me afat 15 vjet¹⁷. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer është 25.656,29 euro.

15.2 Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament 91,91 m², rr. “****”. Burimi i krijimit: Kredi dhe dhuratë nga prindërit. Vlera totale: 73.528 euro. Pjesa takuese: 50%. Kontratë porosie datë **.5.2013.

15.2.1 Në të njëjtën deklaratë në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Kontratë kredie për blerje apartamenti me Banka e *** sh.a., datë **.9.2013, për shumën 30.000 euro. Me afat 15 vjet. Kësti mujor 250 euro. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur pa shlyer është 29.693 euro¹⁸.

¹⁴ Subjekti ka bashkëngjitur: Kontrata e Porosisë, nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.5.2013.

¹⁵ Subjekti ka bashkëngjitur: deklaratë datë **.1.2014, nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁶ Subjekti ka bashkëngjitur: vërtetim datë **.10.2016, nga Zyra e Tregtisë Turke; vërtetim datë **.1.2017, GIZ, Deklaratë Noteriale Huaje, Vërtetim nr. ***, datë **.1.2017.

¹⁷ Subjekti ka bashkëngjitur: kontratën e kredisë marrë pranë *** Bank.

¹⁸ Subjekti ka bashkëngjitur: si dokument justifikues kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol.

15.3 Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të hetimit administrativ¹⁹ nga *** Bank, ka rezultuar se likuidime për këtë pasuri është kryer si vijon: (i) me mandatpagesën e datës **.5.2013, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 57.250 euro, në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin: “Blerje apartamenti, Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2013, me burim kursime dhe huamarrje; (ii) me mandatpagesën e datës **.5.2013, shtetasja ***.*** ka depozituar *cash* shumën 16.278 euro, në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin: “Likuidim total apartamenti rep. ***, kol. ***, dt **.5.2013, ap-2-48, me burim: të ardhurat kursime + huamarrje”.

15.4 Shoqëria “****” sh.p.k., me shkresën nr. *** prot., datë **.6.2022, i ka përcjellë Komisionit, (i) kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2013, me palë shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., dhe ***.*** dhe Arbër Çela, në cilësinë e porositësit, të një apartamenti me sip. 91,91 m² në vlerën 73.528 euro; (ii) kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2015, me të njëjtat palë.

15.5 I pyetur nga Komisioni lidhur me adresat e banimit dhe shpenzimet e mobilimit, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit standard (pyetjeve 1 dhe 14) ndër të tjera, ka deklaruar se: “...Dua të sqaroj se apartamenti ku banoj është blerë fillimisht në bashkëpronësi me shtetasen ***.***. Siç kam sqaruar dhe më lart, shtetasja në fjalë është kushërira ime e dytë (baballarët tanë janë djem tezeshe). Duke qenë se kjo shtetase nuk ka pasur banesë të sajën në qytetin e Tiranës, por jetonte me qira, menduam bashkërisht të blinim një banesë në bashkëpronësi, në mënyrë që të mos kishim shpenzime qiraje dhe po ashtu ta kishim si formë investimi. Në fillim, në këtë apartament kemi banuar bashkë për 1 vit dhe më pas rreth muajit mars 2016, shtetasja ***.*** është larguar, duke lënë pjesën e saj ideale në përdorim pa qira. Kjo situatë ka vazhduar deri në vitin 2018, kur prindërit e mi kanë vendosur të blejnë pjesën ideale të bashkëpronësisë...”.

15.6 Ndërsa, i pyetur nga Komisioni lidhur me aftësisë financiare të bashkëpronares ***.*** për të investuar në këtë pasuri, në përgjigjet e pyetësorit datë 31.5.2021²⁰, subjekti i rivlerësimit pasi ka deklaruar se “...në vlerësimin tim shtetasja ***.*** nuk duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur me mua në kuptim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke referuar raste nga praktika e ndjekur nga Kolegji, ndër të tjera ka deklaruar dhe “...Pavarësisht sa më sipër, në rastin e shtetasës ***.***, në momentin e blerjes së apartamentit, kjo shtetase ka pasur kursimet e saj nisur nga puna e saj pranë Zyrës *** të Tregtisë. Ndërsa në dijeninë time një pjesë të shumës e ka marrë në formë huaje nga shtetaset ***.*** dhe ***.*** dhe e ka shlyer tashmë plotësisht. Bashkangjitur do të gjeni të skanuara deklaratën noteriale, nr.*** rep., nr.*** kol., datë **.1.2017 dhe deklaratën noteriale dt.**.2.2019, që më janë vënë në dispozicion nga kjo shtetase për ekzistencën e marrëdhënies së huas midis saj dhe shtetaseve ***.*** dhe ***.***. Ndërkohë, nga ana ime, në Deklaratën “Vetting” kam dorëzuar dhe disa vërtetime të pagës së shtetasës ***.***”.

15.7 Bashkëngjitur pyetësorit si më sipër, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion dhe dy deklarata noteriale, atë me nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.1.2017 (paraqitur nga subjekti edhe në ILDKPKI me dosjen e plotësuar për Vetting), sipas së cilës ***.*** deklararon se i ka dhënë shtetasës ***.*** hua shumën 8.000 euro, si dhe deklaratën noteriale e datës **.12.2019,²¹ sipas së cilës shtetasja ***.*** deklaroi se ka marrë hua nga shtetasja ***.*** shumën 10.000 euro, për blerjen e një apartamenti në Tiranë.

¹⁹ Konfirmim bankar i *** Bank me nr.*** prot., datë **.5.2013; Shkresa e *** Bank nr.*** prot., datë **.6.2022.

²⁰ Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit datë 31.5.2021.

²¹ Deklaratë kjo e vënë në dispozicion për herë të parë gjatë hetimit administrativ.

15.8 Përveç sa më sipër, i pyetur në pyetësorin standard, nëse ka marrë ndonjëherë ndonjë borxh nga persona apo shoqëri private, subjekti i rivlerësimit deklaroi për herë të parë edhe marrëdhënien e huas në shumën 30.000 euro, marrë shtetasit ***.***, përdorur për blerjen e pasurisë “apartament”, duke vënë në dispozicion “Kontratë huaje-lekësh” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2013, me palë huadhënëse ***.*** dhe palë huamarrëse subjekti i rivlerësimit, z.Arbër Çela, me objekt: dhënie hua e një shume të hollash 30.000 euro për nevoja familjare. Në këtë kontratë përcaktohet se pala huamarrëse deklaroi se shumën e marrë hua prej 30.000 euro do t’ia shlyejë *cash* në dorë, me lëvrimin e një kredie pranë *** Bank.

15.8.1 Nga lëvizjet e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë *** Bank, rezultoi se në datë **.9.2013, është disbursuar kredia në shumën 30.000 euro në llogari të subjektit dhe në datë **.9.2013, shuma 30.000 euro është transferuar në llogarinë e shtetasit ***.*** me përshkrimin: transfertë tek ***.***, kthim borxhi²².

15.8.2 Për të provuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratë noteriale të shtetasit ***.*** me nr *** rep., nr. *** kol., të datës **.10.2013, sipas së cilës ky shtetas deklaroi se huaja 30.000 euro, marrë nga subjekti i rivlerësimit, është likuiduar tërësisht dhe nuk ka asnjë pretendim lidhur me të.

15.8.3 Për sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave të shtetasit ***.*** për të krijuar shumën e dhënë hua në vlerën 30.000 euro, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit standard, ka vënë në dispozicion të hetimit ekstraktin e QKB-së së të Personit Fizik “****.***”, me aktivitet “prodhim dhe tregtim materiale ndërtimi”, regjistruar në vitin 2000, aktiv deri në 2013²³.

15.9 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka vlerësuar që çështja të shihet në drejtimin e përcaktuar në nenin D, pika 5, në vijim të rrethanave faktike dhe jurisprudencës së KPA-së, duke konsideruar znj. ***.***, në përputhje me nenin 3 (14) të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar: (i) vërtetësinë e deklarimeve në Deklaratën “Vetting” se kontributi ka qenë në shumën 36.764 euro, ndryshe nga sa ka rezultuar nga gjendja faktike gjatë hetimit administrativ, nga ku konstatohet kontributi i subjektit në shumën 57.250 euro; (ii) nuk është deklaruar burimi konkret i të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në raport me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, duke ndryshuar burimin gjatë hetimit administrativ; (iii) derisa të provohet e kundërta për sa më sipër, subjekti rezultoi në pamundësi financiare në shumën prej -7.304.299 lekë, për krijimin e kësaj pasurie.

15.10 Në përgjigje të barrës së provës, në prapësimet e tij datë 21.11.2022, subjekti ka deklaruar ndër të tjera se: “(i) ... vlerësoj se rezultoi tërësisht e provuar se në këtë pasuri jam bashkëpronar në ½ pjesë dhe kontributi im është sa gjysma e vlerës së investimit (36.764 euro). Prezumi i Komisionit se meqenëse mandati bankar në shumën 57.250 euro mban emrin tim vërtetoi se aq është edhe vlera ime e investimit, nuk është i bazuar në ligj.... Si burim për kryerjen e investimit kanë shërbyer të ardhurat e mia dhe kushërirës sime. Sqaroj se në momentin e kryerjes së pagesës së shumës 57.250 euro kemi qenë të dy prezent në *** Bank. Pikërisht të dyja këto mandate provojnë katërçipërisht se investimi është kryer nga të dy ne, në pjesë të barabarta dhe se burimi i investimit për secilin nga ne kanë qenë kursimet dhe huamarrjet respektive.

*Nuk ka asnjë të dhënë faktike që pjesa apo kontributi im të jetë më i madh. Kam deklaruar dhe shpjeguar me saktësi, si pjesën time takuese (1/2), ashtu edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këtë kuadër nuk ka asnjë arsye se përse, referuar qëndrimin të konsoliduar nga KPA e të cituar nga vetë Ju, bashkinvestitorja ***.****

²² Shuma është tërhequr po atë ditë në *cash* nga shtetasi ***.***.

²³ Referuar ekstraktit të QKB-së, aktiviteti është pezulluar në datën **.2.2013.

të konsiderohet person tjetër i lidhur me mua, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr.84/2016; (ii) ... konstatimi i Komisionit se kam shtuar burimin në blerjen e kësaj pasurie gjatë hetimit administrativ nuk është i bazuar në prova dhe e kundërshtoj atë. Marrëdhënia ime me shtetasin ***.*** rezulton tërësisht e provuar nga Kontratë Huaje Lekësh nr. *** Rep., nr.*** Kol., datë **.6.2013; Deklarata Noteriale nr. *** Rep., nr.*** Kol., datë **.10.2013, nga praktika e kredisë pranë *** Bank, përshkrimi i përdorur nga ana ime në mandatin bankar të vitit 2013, për kthimin e huas ***.***, si dhe mandati i pagesës në favor të *** sh.p.k, me përshkrim: Kursime plus huamarrje. Dokumente këto, të cilat janë krijuar të gjitha në vitin 2013, pothuajse 10 vite përpara deklarimeve të mia dhënë Komisionit. Vlerësoj të sqaroj paraprakisht se huaja e marrë nga ana ime shtetasit ***.*** nuk është deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie për shkak të faktit se ajo është përdorur vetëm për rreth 3 muaj, derisa u lëvrua dhe disbursua kredia nga *** Bank sh.a dhe duke qenë se ky veprim ka filluar dhe përfunduar brenda të njëjtit vit, deklarimi nuk përmbushte kriterin ligjor si hua me detyrim deklarimi nga ana ime pranë ILDKPKI-së. Kredia është marrë me qëllim shlyerjen e shumës marrë ***.***, ajo është me afat 15-vjeçar dhe vazhdon të shlyhet edhe sot nga unë...

Sqaroj se si përpara ILDKPKI-së, ashtu edhe në Deklaratën “Vetting, jam përqendruar duke saktësuar dhe sjellë dokumentacion të plotë provues për pjesën time të investimit. Duke qenë se shtetasja ***.*** nuk konsiderohej dhe as konsiderohet, për shkak të ligjit, person i lidhur apo person tjetër i lidhur me mua, si dhe referuar faktit që ajo nuk ka qenë dhe nuk është subjekt deklarimi, si për sa u përket shpjegimeve, ashtu edhe sa i përket burimit të investimit të pjesës së saj Ju jam referuar atyre të dhënave, shpjegimeve dhe dokumenteve që më janë vënë në dispozicion prej saj dhe, meqenëse nuk më është kërkuar dokumentacion shtesë, nuk kam qenë ezaurues në depozitimin e tij”²⁴.

15.11 Në prapësimet e tij, subjekti ka trajtuar dhe analizuar dhe burimet e ligjshme të shtetasve të mësipërm ***.*** dhe ***.***, duke vënë në dispozicion dhe akte, me anë të të cilave ka pretenduar se provohen burimet e deklaruara për ta.

15.12 Në përfundim, në vendimin e arsyetuar, Komisioni ka vlerësuar se: [...] Pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit, akteve të administruara, dëgjimit të parashtrimeve të subjektit në seancë publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, konkludon se investimi i subjektit të rivlerësimit, në pasurinë apartament banimi në Tiranë është në shumën 36.764 euro (ose 50%), duke e konsideruar znj. ***.*** si bashkinvestitore në këtë pasuri. Në këtë konkluzion të arritur nga trupi gjykues rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të saktë. Lidhur me mundësitë financiare me burime të ligjshme për të investuar shumën 36.764 euro, nga hetimi rezultoi se ai ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e saj, duke pranuar dhe marrë në konsideratë huan e shtetasit ***.***, si burim primar në shumën 30.000 euro dhe kredinë hipotekore, të marrë brenda vitit 2013, si burim fundor, kursimet e tij në shumën 387.540 lekë [2.764 euro], si dhe dhuratë nga prindërit në shumën 4.000 euro²⁵ [...].

15.13 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara në dosje të Komisionit, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 6.2.2023, i drejtohet juridiksionit kontrollues të Kolegjit, për çështjet lidhur me: (i) Pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit për të investuar në përputhje me kontributin e tij real, për pasurinë “Apartament me sip. 91,91 m²” në rrugën “****”; (ii) Pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare të bashkëpronares ***.***, për të investuar bashkërisht në apartamentin me sip. 91,91m,² në rrugën “****”; (iii) Pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare të huadhënësit z. ***.*** për t’i dhënë subjektit të rivlerësimit huan në shumën 30.000 euro, e cila u përdor si

²⁴ Referohuni aktit: Shpjegime të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, për rezultatet e hetimit, kryesisht të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 21.11.2022.

²⁵ Referohuni f. 15 e në vijim të Vendimit të Komisionit.

burim për blerjen e pasurisë “Apartament me sip. 91,91 m² në rrugën “****”, sikundër do të trajtohen në vijim:

15.14 (i) Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 91,91 m² në rrugën “****”, duke pasur në vëmendje rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së,²⁶ është konstatuar sa vijon:

15.14.1 Referuar kontratës së porosisë datë **.5.2013, me palë porositëse Arbër Çela dhe ***.*** dhe palë sipërmarrëse shoqëria “****” sh.p.k. është porositur pasuria *apartament me sipërfaqe 91,91 m² në rrugën “****”, Tiranë, me vlerë totale 73.528 euro. Në këtë kontratë është parashikuar se çmimi do të likuidohet me lidhjen e kësaj kontrate. Në dosje rezulton e administruar dhe kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2015, me të njëjtat palë kontraktuale.*

15.14.2 Me certifikatën e pronësisë lëshuar nga ZRPP Tiranë më datë **.6.2015, konfirmohet e regjistruar në titull pronësie të Arbër Çela dhe ***.*** me ½ pjesë secili, apartament me sipërfaqe 82,44 m², me pasurie nr.*** z.k.***, vol.***. f.***, ndodhur në rrugën “****”.

15.14.3 Me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.10.2018, ***.***, i ka shitur pjesën e saj takuese të apartamentit, babait të subjektit të rivlerësimit për shumën 40.000 euro.

15.14.4 Sipas dokumentacionit të administruar në dosje, pagesat për blerjen e kësaj prone janë kryer si më poshtë:

(i) Depozitim në *cash* nga Arbër Çela, të shumës prej 57.250 euro në llogari të kompanisë “****” sh.p.k. pranë *** Bank, me përshkrim transaksioni “Çela Arbër, blerje apartamenti nr.*** rep.,nr. *** kol., datë **.5.2013. Burimi i deklaruar i fondeve: kursime + hua”.

(ii) Sipas vërtetimit të *** Bank konfirmohet transaksioni bankar i depozitimit në *cash* nga subjekti i rivlerësimit: “Blerje apartamenti, kontratë porosie ndërmjet “****” sh.p.k. me përfaqësuese ligjore znj. ***.***, me ID *** dhe ***.***, ID *** dhe Arbër Çela, ID ***, sipas kontratës së porosisë dorëzuar pranë Bankës gjatë depozitimit të shumës së sipërpërmendur”.

(iii) Depozitim në *cash* nga ***.*** në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. pranë *** Bank në vlerën 16.278 euro më datë **.5.2013, me përshkrim transaksioni: “****.***, likuidim total i apartamentit rep. ***. kol. ***. Kursime të ardhura+ huamarrje”.

15.14.5 Nga sa më sipër, duket se pagesa për blerjen e apartamentit nuk është bërë në shumën të barabarta nga bashkëpronarët dhe subjekti ka kontribuar për 78% të çmimit.

15.14.6 Bazuar në sa më sipër konstatuar, nisur nga gjendja faktike e akteve, vlerësohet se ekzistojnë gjetje në lidhje me kontributin real të subjektit të rivlerësimit në krijimin e kësaj pasurie, si dhe rrethanave të pazakonta në të cilat kjo pasuri është krijuar, përdorur dhe shitur, që e çojnë vlerësimin drejt dyshimeve të arsyeshme për fshehje pasurie nëpërmjet bashkëpronares dhe, si rrjedhojë, lind nevoja e shpjegimeve të burimeve të ligjshme financiare të bashkëpronares²⁷.

15.14.7 Në kontratën e porosisë dhe kontratën përfundimtare të shitjes së pasurisë së paluajtshme, nuk rezultojnë dispozita për pjesët takuese apo kontributin e secilit prej bashkëpronarëve. Certifikata e Pronësisë specifikon pjesët takuese ½.

15.14.8 Për sa më sipër, rezulton se ka prova të qarta nga informacioni i vënë në dispozicion nga Banka, se subjekti i rivlerësimit faktikisht ka paguar shumën prej 57.250 euro ose 78% të çmimit të blerjes së apartamentit.

²⁶ Referohuni f. 3 – 5 të aktit “Rekomandim i ONM-së”.

²⁷ ONM ka listuar jurisprudencën e KPA-së, p.sh. vendimin e KPA nr. 34/2019, për ***.***, prg. 92.7; Vendimi i KPA-së nr. 20/2020, për ***.***, prg. 21.4. Vendimi i KPA-së nr.2112020, për ***.***, prg. 74.

15.14.9 Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të justifikonte burimin e ligjshëm të shumës prej 57.250 euro, në momentin e depozitimit në *cash* në sistemin bankar²⁸. Në përshkrimin e bërë për qëllimin e transaksionit bankar të depozitimit të shumës 57.250 euro, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burime të tij,²⁹ pa përmendur burimet e bashkëpronares tjetër.

15.14.10 Deklarimi i subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ se: “Prezumimi i Komisionit, se meqenëse mandati bankar në shumën 57.250 euro mban emrin tim, vërteton se aq është edhe vlera ime e investimit, nuk është i bazuar në ligjin bankar apo ndonjë ligj tjetër”, nuk mund të pranohet³⁰, duke pasur parasysh elementet dhe dokumentet e rezultuara nga hetimi.³¹

15.14.11 Komisioneri Publik, pasi verifikoi aktet në dosje të Komisionit, për sa më sipër, vëren se rrethanat e pasqyruara në Rekomandimin e ONM-së, qëndrojnë. Mandatpagesat e vëna në dispozicion të hetimit dhe përshkrimet respektive të tyre, provojnë pagesën prej 57.250 euro nga ana e subjektit, ose 78% të çmimit total të pasurisë “Apartament 91,91 m²” në rrugën “****”, Tiranë. Në këtë kuadër, sikundër konstatuar dhe nga barra e provës kaluar subjektit nga Komisioni, konstatohet pamjaftueshmëri e burimeve të ligjshme të subjektit për të mbuluar këtë pagesë. Edhe në rast të konsiderimit të pronësisë në masën 50%, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë burimin e ligjshëm të znj. ****.***, për pagesën e shumës në masën 50% të vlerës së apartamentit, në referencë të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, apo burimin e ligjshëm të huas në shumën 30.000 euro, marrë nga shtetasit ****.***, sikundër do të trajtohet në vijim të këtij ankimi.

15.15 (ii) Lidhur me burimin e ligjshëm të investimit të bashkëpronares **.***, duke patur në vëmendje rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së,³² është konstatuar sa vijon:**

15.15.1 Bazuar në sa më sipër trajtuar, vlerësohet e një rëndësie të veçantë kryerja e një hetimi dhe vlerësimi të plotë të burimeve financiare të ligjshme të bashkëpronares ****.***, për të investuar shumën e pretenduar në apartament.

15.15.2 Lidhur me analizën e të ardhurave të ligjshme të ****.*** nga punësimi në ambasadën Turke, gjykohet se legjislacioni tatimor bazohet në “parimin e vendbanimit”, pra të ardhurat nga puna e kryer, taten në burim në vendin e punës. Shtetasja ****.*** konsiderohet si rezidente për qëllime tatimore në Republikën e Shqipërisë në bazë të dispozitave të nenit. 3, f. 1, 2 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

²⁸ ONM ka theksuar se, sipas ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, neni 12, pika 3, të gjitha transaksionet në *cash* në vlerë ose më shumë se 1.000.000 lekë (ose ekuivalente në valutë) si transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura, duhet të raportohen nga subjektet (në këtë rast banka) në FIU.

²⁹ “Çela Arbër, blerja e një apartamenti rep. ****, kol ****, dt. **.5.2013. Burimi i deklaruar i fondeve: *Kursime+ hua*”.

³⁰ ONM ka referuar jurisprudencën e KPA-së në vendimin e KPA-së (JR) nr. 33, datë 3.11.2021, mbi ****.*** (“[...] Në këtë kuptim është i saktë pretendimi i subjektit, se deklarimi i kuotës së pjesës në 1/3 për pronën ‘apartament me sipërfaqe 65 m²’, nuk do të thotë apriori se edhe kontributi në krijimin e tij ka qenë në të njëjtën masë në vlerë monetare”, prg. 54).

³¹ Duhet pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit ka shmangur deklarimin e shumës prej 57.250 euro, në deklaratën vjetore të vitit 2013, e cila në fakt përbën shumën e depozituar prej tij në favor të shoqërisë. Gjithashtu vlen të theksohet se: (i) faturimi i furnizimit me energji elektrike ka filluar në qershor 2015, ndërsa faturimi i furnizimit me ujë ka filluar në korrik 2015, gjë që tregon se apartamenti ka qenë në përdorim përafërsisht 9 muaj para se të lindte vajza e subjektit të rivlerësimit (dmth., më **.2016);

(ii) deklaratat e subjektit të vlerësimit se bashkëpronari u largua nga apartamenti dhe u transferua në një apartament me qira dhe e lejoi subjektin ta përdorte atë falas për 2 vjet, derisa ajo t’ia shiste pjesën e saj të aksioneve babait të subjektit të rivlerësimit.

(iii) Blerja e pjesës aksionare të shtetasit ****.*** të banesës nga babai i subjektit vetëm në vitin 2018, burim nga të ardhurat e shitjes së banesës së vetme që i ati posedonte në qytetin e Lushnjës, ndërsa ai vazhdon të jetojë në këtë qytet duke marrë me qira një apartament tjetër dhe statusi i tij si person fizik rezulton aktiv për ushtrimin e aktivitetit të tij privat në këtë qytet edhe vazhdon aktualisht.

³² Referohuni f. 6 – 8, të Rekomandimit të ONM-së, datë 6.2.2023.

15.15.3 Rrjedhimisht, detyrimet tatimore përkatëse duhet të ishin paguar në shtetin ku kryhet puna. Përveç kësaj, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokument që të vërtetojë se një pjesë e detyrimit tatimor në lidhje me të ardhurat e shtetases ***.*** ishin paguar në shtetin turk (sikurse pretenduar).

15.15.4 Bazuar në përgjigjet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim ISSH), lëvizjeve të llogarive bankare dhe vërtetimit të punëdhënësit të shtetases ***.***, në lidhje me të ardhurat e saj, kanë rezultuar të dhëna të ndryshme mbi të ardhurat e përfituara nga kjo e fundit³³. Për qëllime të këtij procesi, të vetmet të ardhura të ligjshme që plotësojnë standardet e parashikuara në neni D pika 3 e aneksit të Kushtetutës, janë ato të konfirmuara nga ISSH.

15.15.5 Për sa i përket dy huave të pretenduara në shumat 8.000 euro dhe 10.000 euro marrë nga shtetasja ***.***, vlerësohet se ekzistenca e tyre mbetet e diskutueshme, por edhe nëse merren në konsideratë, subjekti nuk provoi me dokumentacion burimin financiar të huadhënësve për shumat në fjalë. Marrëdhënia e huas mbeti në nivel deklarativ³⁴.

15.15.6 Si rezultat i sa më sipër, analiza financiare e bashkëpronares, shtetases ***.***, rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme³⁵ për të mbuluar pagesën e kontributit të pretenduar prej 36.764 euro nga shtetasja ***.***.

15.15.7 Komisioneri Publik, pasi verifikoi aktet në dosje të Komisionit, për sa i përket ligjshmërisë së të ardhurave personit tjetër të lidhur ***.***, vëren se, sikundër analizuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, subjekti i rivlerësimit, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi burimet e ligjshme financiare të bashkëpronares. Nga analiza e akteve në dosje, ka rezultuar se shuma e të ardhurave të ligjshme, të cilat plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, bazuar në aktet e vëna në dispozicion nga ISSH në korrespondencën me Komisionin gjatë hetimit administrativ, rezultojnë në shumën llogaritur nga Komisioni rreth 1.185.329 lekë për periudhën 2008-2013, të cilat nuk mjaftojnë për të mbuluar shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë dhe pagesën e pjesës 50% të vlerës së pasurisë.

15.15.8 I pyetur nga ILDKPKI –ja, në procesverbalin e mbajtur në datën 20.10.2014,³⁶ subjekti, në përgjigje të pyetjes mbi burimet e ligjshme të shtetases ***.***, ka vendosur në dispozicion të inspektorëve përgjegjës vërtetimet e pagave të bashkëpronares ***.***, të datave **.11.2014 dhe **.12.2014, lëshuar nga Ambasada Turke.

15.15.9 Ndërsa, me dorëzimin e Deklaratës “Vetting”, subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI vetëm deklaratën noteriale nr.***/** datë **.1.2017 të shtetaseve ***.*** dhe ***.*** mbi huan në vlerën 8.000 euro, dhënë kësaj të fundit, me qëllim blerje apartamenti.

15.15.10 Në vlerësim të akteve në dispozicion të hetimit administrativ, nisur dhe nga fakti se vërtetimet e pagave për ***.*** konfirmojnë vlera ndjeshëm të ndryshme nga sa rezultojnë të

³³ Për më, tepër referohuni përmbledhjes në formë tabelore në faqen nr.7 të Rekomandimit.

³⁴ Huat nuk janë deklaruar asnjëherë pranë ILDKPKI, si burim të ardhurash për pjesën takuese të bashkëpronarit, si dhe gjatë hetimit të kryer në vitin 2014. E vetmja gjurmë e këtyre transaksioneve në lidhje me kredinë e 8.000 euro daton pas Deklaratës “Vetting” (sipas deklaratës noteriale datë **.1.2017, shuma prej 8.000 euro në maj 2013 është dhënë hua nga shtetasi ***.*** ndaj ***.*** dhe është deklaruar se ***.*** ka shlyer shumën e 5.000 euro dhe ka një detyrim të papaguar prej 3.000 euro). Më datë **.6.2018 ***.*** ka transferuar shumën prej 3.000 euro nga llogaria e saj bankare shtetases ***.*** (nëna e ***.***). Deklarata noteriale e datës **.12.2019, në bazë të së cilës ***.*** ka marrë nga kushërira e saj shumën prej 10.000 euro, është hartuar gjatë hetimit administrativ dhe nuk është deklaruar në Deklaratën “Vetting”. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se huamarrja është deklaruar nga bashkëpronari në momentin e kryerjes së pagesave në bankë, ku në mandatin e datës **.5.2013 (burimi i deklaruar si “kursime plus huamarrje”) vihet re se përshkrimi i transaksionit bankar për burimet e këtij apartamenti është i njëjtë për të dy bashkëpronarët dhe shuma e kredisë së kërkuar tejkalon pagesën faktike të ***.*** (dmth., 18.000 EUR - shuma e huadhënies VS 16.278 EUR)- prandaj ky fakt mund të konsiderohet i mjaftueshëm për të vërtetuar ekzistencën e marrëdhënieve të pretenduara të huas.

³⁵ Referohuni tabelës në f. 8 të Rekomandimit, në të cilën konstatohet pamjaftueshmëri financiare në vlerën – 4.601.765,30 lekë.

³⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë **.7.2022.

deklaruar pranë organeve përgjegjëse (ISSH), ashtu si dhe trajtuar nga Komisioni, Komisioneri Publik vlerësoi dhe analizimin e mundësisë financiare të shtetases ***.***, bazuar në kreditimet e pagave në llogarinë bankare të kësaj të fundit pranë ***, çelur në vitin 2012. Rezulton se për periudhën 2012 - maj 2013 në këtë llogari janë kredituar paga në shumat 250-750 euro/muaj, duke arritur në shumën totale 11.248 euro. Këto të ardhura kryesisht janë investuar në depozitë pranë së njëjtës bankë dhe deri në momentin e kryerjes së pagesës, maj 2015, rezulton se është akumuluar shuma prej 10.285 euro, shumë e cila është tërhequr e plotë në datën **.5.2013 (një ditë përpara pagesës së këstit për blerje apartamenti nga ana e ***.***).

15.15.11 Bazuar në sa më sipër, edhe nëse merret në konsideratë shuma prej 10.285 euro me burim të ardhura nga pagat e kredituara në llogarinë bankare të shtetases ***.***, dhe tërhequr në *cash* një ditë përpara transaksionit të blerjes, si dhe huaja si më sipër, në vlerën 8.000 euro, (në vlerën totale prej 18.285 euro) Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit përsëri nuk provoi burimet e ligjshme të shtetases ***.*** për të mbuluar pagesën e deklaruar në shumën 50% të vlerës së pasurisë *apartament prej 36.764 euro*.

15.16 (iii) Në lidhje me huan marrë shtetasis *.***, duke pasur në vëmendje rrethanat e parashtruara në Rekomandimin e ONM-së,³⁷ është konstatuar sa vijon, për këtë marrëdhënie:**

– Sipas kontratës së huas datë **.6.2013, shtetasi ***.*** ka deklaruar se ka në pronësi shumën prej 30.000 euro, të cilën ia ka dhënë z. A. Çela, për një afat 3-mujor për nevoja familjare. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se kishte marrë shumën prej 30.000 euro, të cilën duhej të shlyente me marrjen e kredisë pranë *** Bank.

– Me deklaratën noteriale datë **.10.2013, shtetasi ***.*** ka deklaruar se huaja e dhënë z. A. Çela në maj 2013, në shumën 30.000 euro, me qëllim blerje apartamenti, të hartuar para noterit (me akt noterial të datës **.6.2013, ku është specifikuar afati 3-mujor për shlyerjen), është likuiduar plotësisht dhe nuk ka asnjë pretendim për huan ose ndonjë penalitet për vonesën e pagesës.

– Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, pranë *** Bank rezulton se kredia është disbursuar në datën **.9.2013 në llogarinë e subjektit. Në datën **.9.2013 është kryer një transfertë bankare në shumën 30.000 euro nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e ***.*** me përshkrimin: “kthim borxhi”. Shuma e tërhequr nga ***.*** në të njëjtën datë.

– Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë shumë si burim në deklaratën e vitit 2013, në kuadër të detyrimit që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003 dhe në Deklaratën “Vetting” sipas Udhëzimit të Inspektorit të ILDKPI nr. 4095, datë 10.10.2016, pika 7. Në vlerësimin e ONM-së kjo konsiderohet si mangësi dhe pasaktësi në deklaram – për sa kohë që ekzistenca e kësaj marrëdhënie vërtetohet me prova të tjera³⁸.

15.16.1 Komisioneri Publik, ashtu sikundër trajtohet edhe në Rekomandimin e ONM-së, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton ta ketë deklaruar këtë hua asnjëherë deri përpara pyetësorit standard, as në Deklaratën “Vetting” dhe as në përgjigje të procesverbalit të vitit 2014, pranë ILDKPKI-së, duke kryer kështu deklaram të pasaktë, edhe pse kjo marrëdhënie rezulton e provuar nga aktet në dosje.

15.17 (iv) Lidhur me burimet e ligjshme të huas në vlerën 30.000 euro, dhënë nga z. *.*****

³⁷ Referohuni f .8 – 9 të Rekomandimit të ONM-së, datë 6.2.2023.

³⁸ Ky qëndrim mbështetet edhe në jurisprudencën e KPA-së (shihni Vendimin e KPA-së (JR) nr. 9, datë 18.4.2019, prg. 10.1.1, 10.1.2.)

Bazuar në sa më sipër, në Rekomandimin e paraqitur, si dhe në nenin 32, pika 4, ligjit nr. 84/2016 janë analizuar burimet e ndryshme, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si më poshtë:

15.18 Të ardhurat nga aktiviteti i biznesit

15.18.1 Ka rezultuar se shtetasi ***.*** është regjistruar si biznes që prej vitit 2000, me aktivitet “Prodhimi materialesh ndërtimi”. Bazuar në përgjigjet e Drejtorisë Rajonale të Taksave, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë **.6.2022, si dhe nga burime të tjera të hapura të informacionit, kanë rezultuar të dhëna financiare për aktivitetin e shtetasit ***.*** për periudhën 2008-2013³⁹.

15.18.2 Nga analizat e pasqyrave financiare të personit fizik “***.***”, duket se fitimi është akumuluar në zërin “fitim i pashpërndarë”, si pjesë e kapitalit neto të vitit 2010, dhe rrjedhimisht nuk rezultojnë shuma të tërhequra/në dispozicion të pronarit. Shuma e akumuluar e fitimit nuk rezulton në *cash* në arkë, por është reflektuar në një rritje të aksioneve/inventarit të biznesit.

15.18.3 Për sa më sipër, vlerësohet se, bazuar në bilancin e shoqërisë, nuk rezulton disponibilitet i gjendjeve *cash* dhe fitimi është akumuluar në zërin “fitim i pashpërndarë” të shoqërisë dhe është reflektuar në një rritje të aksioneve, rrjedhimisht, nuk provohen burimet e ligjshme, deklaruar përdorur për t’i dhënë subjektit të rivlerësimit huan në shumën prej 30.000 euro.

15.19 Të ardhura nga kontrata e premtimit për shitje datë **.01.2013 ndërmjet huadhënësit *.*** dhe shtetases ***.***.**

15.19.1 Sipas kontratës premtim shitje datë **.1.2013, z. ***.*** rezultojnë si palë shitëse për shitjen e dy parcelave në pronësi të tij (truell me sipërfaqe 3.750 m² dhe 60 m² objekt dhe truell me sipërfaqe 1.900 m²). Në këto parcela ndodhet aktiviteti i biznesit i shtetasit ***.*** dhe në këtë pronë është vendosur edhe një stok materialesh/inventari. Në kontratë parashikohet që stoku duhet të transferohet/largohet përpara datës së nënshkrimit të kontratës së shitjes dhe se blerësi ta marrë në zotërim pas shitjes së stokut të materialeve tek të tretët. Çmimi i parcelave ishte përcaktuar 100.000 euro. Pala blerëse deklaronte se shumën 4.500.00 lekë ia kishte paguar shtetasit ***.*** si parapagim për blerjen, me para në dorë jashtë zyrës së noterit. Me shitjen e të gjitha materialeve të inventarit, palët duhet të nënshkruanin kontratën përfundimtare të shitjes së pronës së paluajtshme.

15.19.2 Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit, ONM ka trajtuar se, lidhur me këtë burim të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

- i.* Nuk ka të dhëna, që kjo shumë është përdorur si burim për huan, kontrata nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit të parë, por është vënë në dispozicion nga ky i fundit vetëm më vonë gjatë hetimit administrativ;
- ii.* Sipas përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë me nr. *** prot., datë **.8.2022, rezulton se ky akt nuk është e regjistruar në regjistrin noterial, si dhe mungon akti i revokimit që vë në dyshim vërtetësinë e kësaj marrëdhënie;
- iii.* Nga analiza e kontratës, rezulton se palët e përfshira kanë nënshkruar si individë dhe jo si subjekte biznesi. Sipas përgjigjes së Drejtorisë Rajonale Tatimore me nr. *** prot., datë **.10.2022, ka rezultuar se: “nga verifikimi i dokumentacionit të subjektit ***.*** me NIPT ***, nuk rezulton se transaksionet e përmendura në kontratën e premtimit të shitjes të jenë pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2013, në gjendjet/lëvizjet e *cash-it* ose librat e shitjes së subjektit tregtar, të depozituara nga ky i fundit në sistemin informatik”.

³⁹ Paraqitur në formë tabelore në faqen nr. 9, të aktit “Rekomandim i ONM-së”.

15.19.3 Rrjedhimisht, të ardhurat e pretenduara nga kjo kontratë nuk mund konsiderohen si të ardhura të ligjshme bazuar në ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe dispozitave kushtetuese përkatëse.

15.20 *Tërheqjet nga llogaritë personale bankare*

15.20.1 Në përgjigjet ndaj rezultateve të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova shtesë në mbështetje të argumentit mbi mundësitë financiare të z. ***.*** për të dhënë hua shumën prej 30.000 euro.⁴⁰

15.20.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të shtetasit ***.*** rezulton se ky i fundit ka tërhequr gjatë periudhës 2.2012 - 2.2013 nga llogaria e tij në ***, shumën prej rreth 3.7 milionë lekë, ndërkohë që ka pasur gjendje rreth 5 milionë lekë, në formën e bonove të thesarit. Burimet e kursimeve në llogaritë e tij pranë *** Bank, ndër vite janë: (i) bilanci i bartur që nga viti 2004; (ii) depozitimet *cash* ndër vite; (iii) të ardhurat nga interesi; (iv) disa transfertat nga llogaria e kompanisë së tij në vitin 2010.

15.20.3 ONM vlerëson se posedimi i likuiditeteve në llogaritë bankare të shtetasit ***.*** dhe tërheqjet nga llogaritë e tij, nuk justifikojnë domosdoshmërisht burimin e ligjshëm të këtyre shumave dhe ligjshmëria e këtyre shumave mbetet e diskutueshme.

15.20.4 Gjithashtu, nuk duket shumë bindës fakti se huadhënësi kishte tërhequr disa herë shuma të vogla nga overdrafti i tij gjatë vitit 2012-2013, për t'i dhënë një hua subjektit të rivlerësimit në shumën prej 30.000 euro.

15.20.5 Lidhur me tërheqjet nga llogaritë e tjera bankare të tij, të cituar nga subjekti i rivlerësimit, ato janë kryer vite përpara se të kryhej huadhënia dhe, si të tilla, është e vështirë të besohet se ato kanë shërbyer si burim për huan.

15.20.6 Si rezultat i analizës së mësipërme, ONM vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës në lidhje me burimin e ligjshëm të huas, në shumën 30.000 euro, e cila është përdorur si burim nga subjekti i rivlerësimit për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit 91,91 m².

15.21 Si përfundim ONM vlerëson, se lidhur me kriterin e pasurisë, të dhënat e rezultuara gjatë hetimit administrativ, ngrenë dyshimin e arsyeshëm për fshehje të pasurisë me sipërfaqe 91,91 m² në rrugën “****”, nëpërmjet bashkëpronares së banesës (***.***). Si rrjedhojë, Komisioni, në konsideratë të elementeve dhe të dhënave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, duhej të kishte arritur në një vlerësim të ndryshëm, në përputhje me atë që është paraqitur në këtë Rekomandim. Vendimi i Komisionit nuk është i plotë në trajtimin çështjeve dhe pranimin e versionit të subjektit rivlerësimit, që ka çuar në konfirmimin në detyrë të tij. Siç tregohet në këtë rekomandim, nga analiza financiare do të rezultonte mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit në shumën **7.304.299 lekë**.

15.21.1 Për më tepër, nuk mund të arrihet në përfundimin se ***.*** kishte të ardhura të ligjshme për t'i dhënë subjektit të rivlerësimit, huan prej 30.000 euro (disponueshmëria e shumës nuk kontestohet, ajo që vihet në dyshim është ligjshmëria e saj) për blerjen e banesës në fjalë.

⁴⁰ Huadhënësi ka kryer këto tërheqje nga llogaritë e tij bankare: (i) nga llogaria e tij personale bankare pranë *** Bank nr.*** ka tërhequr shumën prej 4.487.789 lekë, për periudhën 23.2.2012 - 26.2.2013; (ii) llogaria në Bankën ***, nr.*** deri në maj 2013, tërheqjet *cash* ishin në shumën 7.171.658 lekë; (iii) nga llogaria e tij në *** Bank, ai tërhoqi shumën prej 431.000 lekë, gjatë periudhës maj 2008 - qershor 2008; (iv) nga llogaria e tij bankare pranë *** Bank nga qershori 2010 - dhjetor 2011 ka tërhequr shumën prej 807.700 lekë.

15.22 *Komisioneri Publik*, për sa më sipër, bazuar dhe në trajtimin e detajuar në aktin: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës mbi burimet e ligjshme të huadhënësit, shtetasit ***.***

15.23 Për sa i përket burimeve të pretenduara nga subjekti gjatë hetimit administrativ, vlerësohet se:

15.23.1 Mbi pretendimin e subjektit se si burim për huan 30.000 euro kanë shërbyer: *Të ardhurat nga aktiviteti i biznesit*, nga aktet e administruara, si nga ana e subjektit, ashtu dhe nga korrespondenca e Komisionit me organet tatimore, nuk u provua ekzistenca e kësaj shume e reflektuar në pasqyrat financiare apo në llogaritë bankare të personit fizik, “***.***”.

15.23.2 Mbi pretendimin e subjektit se si burim për huan 30.000 euro kanë shërbyer: *Të ardhurat nga kontrata e premimit për shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.1.2013, ndërmjet huadhënësit ***.*** dhe shtetas ***.****⁴¹, nga aktet në dosje, pasqyra financiare dhe llogari bankare, nuk rezultuan gjurmë të këtij transaksioni, nisur nga vlera e konsiderueshme e transaksionit (4.500.000 lekë).

15.23.3 Mbi pretendimin e subjektit se si burim për huan 30.000 euro kanë shërbyer: *Tërheqjet nga llogaritë personale bankare të z. ***.****, nga verifikimi i akteve në dosje për periudhën deri në maj 2013, nuk kanë rezultuar tërheqje nga llogaritë bankare të personit fizik “***.***”, ndërsa për sa i përket shumave të tërhequra nga llogaria personale e shtetasit ***.*** ka rezultuar se për periudhën 2012 - 2013 janë kryer disa tërheqje në *cash*, por shumat e tërhequra janë në vlerat 200.000 - 700.000 lekë, tërheqje të pjesshme të shtrira në kohë, që nuk duket se mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e shumës 30.000 euro, deklaruar dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

15.24 Në përfundim, në vlerësimin e *Komisionerit Publik*, bazuar dhe në sa trajtuar gjerësisht në aktin: Rekomandimi, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës së Komisionit duke rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë, duke mos konsideruar në mesin e këtyre burimeve, shumën e deklaruar paguar nga shtetasja ***.***, në vlerën e plotë 36.764 euro (pasi sikundër trajtuar më sipër në këtë ankim, rezultoi se ***.*** nuk mbulon vlerën e saj të investimit për një diferencën negative prej – 4.601.765 lekë), si dhe shumën 30.000 euro, me burim hua nga shtetasi ***.***. Diferencë negative në mbulimin e burimeve të ligjshme të bashkëpronares ***.*** do të konstatohet edhe në konsideratë të llogaritjes së të ardhurave nga pagat, në vlerën 10.285 euro (sipas lëvizjeve të llogarisë bankare) dhe përfshirjes së shumës 8.000 euro, deklaruar hua nga shtetasja ***.*** (për rreth – 3.2 milionë lekë).

15.25 Në përfundim për pasurinë “Apartamenti me sipërfaqe 91,91 m,²” në rrugën “***”, Tiranë, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm bazuar në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

IV.B. Lidhur me gjetjet në raportin e DSIK-së

16. DSIK, me raportin mbi kontrollin e figurës, nr. *** prot., datë **.11.2017, ka referuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër *** Çela”. Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, DSIK, me anë të raportit nr.*** prot., datë **.5.2022⁴², ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe i ka referuar Komisionit: “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Arbër *** Çela*”, dhe informohet se: [...] Gjatë periudhës në të cilën

⁴¹ ONM-ja në aktin Rekomandim për paraqitje ankimi ka referuar edhe se gjatë hetimit administrativ, referuar korrespondencës zyrtare me Ministrinë e Drejtësisë, është konstatuar se kontrata nuk rezultoi e regjistruar në Regjistrin Noterial.

⁴² Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr.***, datë **.5.2022.

z. Çela ushtronte detyrën si gjyqtar, dyshohet se është përfshirë në shpërdorim detyre dhe veprimtari korruptive [...].

17. Komisioni, lidhur me konstatimin për dyshime se subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Shkodër, është përfshirë në veprime që kanë sjellë si pasojë shpërdorim detyre dhe/apo veprime korruptive, ka vlerësuar të verifikojë më tej këto të dhëna në formë *indiciesh*. Për këto të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër⁴³ dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ndër të tjera⁴⁴, Komisionit i është përcjellë informacion dhe kopje të vendimeve gjyqësore lidhur me: (i) çështjen penale nr. ***/2019 ndaj shtetasit ***.***; (ii) çështjen penale me të pandehur ***.***, ***.*** (iii) çështjen civile me kërkuese ***.***.

17.1 Vendim penal i gjyqtarit të seancës paraprake me nr.***, datë **.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër

17.1.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër ka përcjellë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***/2018, me palë të pandehur shtetasin ***.***, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “*vrasje me dashje*” mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76 dhe 22 i Kodit Penal dhe “*mbajtje pa leje i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Kjo çështje është regjistruar në datën **.12.2018 dhe, pas rishortimit, më **.12.2018, është caktuar gjyqtari Arbër Çela.

17.1.2 Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit Arbër Çela, me vendimin nr. ***, datë **.2.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë, kthimin e akteve prokurorit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “*vrasje me dashje e mbetur në tentativë*” në “*plagosje e lehtë me dashje*”.

17.1.3 Kundër vendimit nr. ***/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër është paraqitur ankim nga Prokuroria në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku kjo e fundit në vendimin e saj nr.** datë **.3.2019, ka konstatuar se:

(i) Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, për sa i përket kalimit të akteve prokurorisë, *duhet lënë në fuqi vetëm për plotësim hetimi*. Aktet nuk i duhen kthyer Prokurorisë për riformulim akuze.

(ii) Gjykata e Shkallës së Parë është shprehur vetëm për ndryshimin e akuzës së vrasjes së mbetur në tentativë, *por nuk është shprehur* lidhur me veprën penale “*mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”.

(iii) Në dispozitivin e vendimit, gjyqtari është shprehur mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit mbi këtë vendimmarrje. Dispozita e posaçme ligjore së cilës i referohet gjyqtari Arbër Çela në arsyetimin e vendimit nuk përmban në vetvete asnjë përkufizim dhe nuk shprehet për të drejtën e ankimit. Për rrjedhojë nuk mund të arrihej në përfundimin se kundër vendimit nuk lejohet ankim.

17.1.4 Përfundimisht, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin e saj nr.**, datë **.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, me disa ndryshime, duke urdhëruar Prokurorinë të kryejë hetime brenda 60 ditëve.

⁴³ Shkresa nr. *** prot., datë **.6.2022.

⁴⁴ Çështjet e trajtuara në vendimin e Komisionit në funksion të informacionit nga organet ligjzbatuese janë 8 (tetë), përkatësisht: (1) vendim penal me të pandehur ***.***; (2) vendim penal me të pandehur ***.*** e ***.***; (3) vendim penal për pushim procedimi penal me të kallëzuar ***.***; (4) vendim civil me kërkuese ***.*** (***) ; (5) vendim penal me të pandehur ***.***; (6) vendim penal me të pandehur ***.***; (7) vendim penal me të pandehur ***.***; (8) vendim penal për pushim procedimi penal me person të interesuar ***.***.

17.1.5 Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër ka dërguar kërkesën për gjykim të procedimit penal nr. ***/2018, në ngarkim të të pandehurit ***.***, por me akuzë “*plagosje e rëndë me dashje*” dhe “*mbajtje pa leje i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”. Kjo çështje i ka kaluar subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, i cili, me vendimin nr. ***, datë **.7.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin për gjykimin në themel të procedimit penal nr. ***/2018.

17.1.6 Nga fashikulli i procedimit penal nr. ***/2018, i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër⁴⁵, rezulton se fillimisht ndaj të pandehurit ***.*** është caktuar si masë sigurimi personal “arrest me burg”, në mungesë dhe në vijim pas dorëzimit vullnetar të të pandehurit është bërë verifikimi i kushteve të sigurisë për zbatimin e kësaj mase.

17.1.7 Me kërkesë të të pandehurit, ***.***, është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest me burg” në një masë më të butë “arrest në shtëpi dhe garanci pasurore”. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, Arbër Çela, i cili, pas kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për rrëzimin e kërkesës së ***.***, me vendimin nr. ***, datë **.7.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës të të pandehurit ***.*** dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi dhe garanci pasurore”.

17.1.8 Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka vendosur për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, në “plagosje të lehtë me dashje”, në ngarkim të shtetasit ***.***, bazuar në pikën 3 të nenit 332/dh të Kodit të Procedurës Penale.

17.1.9 Referuar vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i ka rezultuar se: (i) duket se subjekti ka marrë vendim të gabuar në zbatim të ligjit procedural penal, pasi kjo procedurë është parashikuar në pikën 3, të nenit 332/d, të Kodit të Procedurës Penale; (ii) Duket se vlerësimi i mungesës së ushtrimit të së drejtës së ankimit është një shkelje procedurale, duke cenuar të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor që afekton gjithashtu edhe indikatorët e përcaktuar në nenin 72/2 të ligjit nr. 96/2016, lidhur me aspektin e njohurive ligjore dhe aftësinë e përgjithshme të subjektit për të interpretuar ligjin; (iii) Duket i dyshimtë rishortimi i kësaj çështje në datën ** dhjetor 2018, pas shortimit të saj vetëm një javë më parë; (iv) Duket se subjekti ka favorizuar pozitën e të pandehurit gjatë vendimmarrjeve të tij.

17.1.10 Për konstatimet e mësipërme i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili ka pretenduar se ka respektuar të gjitha dispozitat materiale dhe procedurale për çështjen në gjykim dhe ka dhënë një vendim të bazuar në ligj dhe në prova. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit që të mos marrë në konsideratë këto të dhëna në vlerësimin e kontrollit të figurës, pasi konstatimet tejkalojnë objektin e veprimtarisë së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas parashikimeve të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

17.1.11 Në këtë këndvështrim, Komisioni ka konkluduar se *e gjen të drejtë këtë kërkesë e vlerëson se konstatimet nuk mund të referohen në vlerësimin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, por elemente të këtyre çështjeve duhet të vlerësohen në kuadër të vlerësimit tërësor dhe atij të cenimit të besimit gjatë ushtrimit të detyrës.*

17.1.12 Për sa më lart, *Komisioneri Publik*, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së, datë 6.2.2023, vlerëson se çështja me palë të pandehur ***.*** duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, si një nënindikator në vlerësimin e kriterit profesional dhe/ose të konsiderohet në vlerësimin tërësor të procedurave bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, për të krijuar bindjen e plotë se subjekti nuk ndodhet në kushtet e papërshtatshmërisë për të vazhduar detyrën.

⁴⁵ Me shkresën nr. *** prot/***/**, datë **.2.2020.

17.1.13 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, qëndrimi i subjekti të rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë **.9.2019, për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “*Vrasje me dashje*”, mbetur në tentativë në atë të “*Plagosjes së lehtë me dashje*” është bërë në referencë të gabuar ligjore, pasi kjo procedurë është parashikuar në pikën 3 të nenit 332/d të Kodit të Procedurës Penale.

17.1.14 Gjithashtu, ky qëndrim i subjektit nuk gjen mbështetje në situatën faktike dhe juridike të rastit konkret, pasi në rrethanat kur nga hetimet e Prokurorisë nuk dilte i qartë fakti penal, subjekti i rivlerësimit duhet t’i kthente aktet për plotësim hetimi, siç ka vendosur edhe Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr. *** datë **.3.2019, e cila ka urdhëruar Prokurorinë të kryejë hetime brenda 60 ditëve nga regjistrimi i akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Shkodër.

17.1.15 Gjithashtu në vlerësimin e Komisionerit Publik, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në dispozitivin e vendimit nr.***, datë **.2.2019, mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit, është në kundërshtimin me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për pushimin e çështjes.

17.2 Vendim penal nr.*, datë **.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër, me kryesues subjektin e rivlerësimit**

17.2.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër ka gjykuar kërkesën penale që i përket procedimit penal me nr. *** akti, me palë të pandehur shtetasin ***.***, dhe shtetasin ***.***, të akuzuar për kryerjen e veprave penale “*Prodhim dhe shitje të narkotikëve*” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

17.2.2 Në përfundim të gjykimit, trupa gjyqësore me kryesues subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, me vendimin nr. ***, datë **.12.2016, ka vendosur: [...]Deklarimin e pafajshëm të pandehurit ***.***, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhim dhe shitje të narkotikëve*”. Deklarim fajtor të pandehurit ***.***, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, për krimin “*Prodhim dhe shitje të narkotikëve*” [...].

17.2.3 Prokuroria Shkodër dhe i pandehuri ***.*** ka ankimuar vendimin dhe Gjykata e Apelit, Shkodër me vendimin nr.***, datë **.4.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.***, datë **.12.2016, dhe deklarimin fajtor të pandehurit ***.*** dhe të pandehurit ***.***, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre me 7 (shtatë vjet) burgim secili. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga Prokuroria dhe të pandehurit.

17.2.4 Në vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër⁴⁶, konstatohen sa vijon:

(i) Pretendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë se dëshmia e punonjësit të policisë, ***.***, mbi fajësinë e të pandehurit, nuk është e besueshme për shkak të komunikimeve telefonike që kanë rezultuar mes tij dhe të pandehurit në momentin e ngjarjes ...nuk është detyrë e gjykatës për t’u analizuar, por e vetë institucionit të policisë, e cila ka të drejtë të hetojë dhe verifikojë shkaqet e këtij komunikimi apo të përcaktojë përgjegjësinë përkatëse.

(ii) Qëndrimi i të pandehurit... që lënda narkotike ishte e tij dhe jo e shtetasit... pra duke përjashtuar bashkëpunimin mes tyre dhe se Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka marrë parasysh deklarimin e këtij shtetasi gjatë fazës së hetimeve se lënda narkotike ishte e të pandehurit se ai thjesht po e mbante në banesë e tij... Këto deklarime nuk janë të besueshme dhe se janë

⁴⁶ Në dosje të Komisionit është administruar vendimi gjyqësor i anonimizuar i cili ka këtë shënim: “Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.”

bërë thjesht për të përfituar nga parashikimet ligjore lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale, për të cilin do të merrej në përgjegjësi penale.

(iii) Gjykata e çmon se është e vërtetë se neni 380 i Kodit të Procedurës Penale parashikon këtë kufizim⁴⁷, por nga ana tjetër në nenin 362, pika 3 e K. Pr. Penale , sanksionon se: [...] Deklarimet e dhëna para prokurorit ose oficerit të Policisë Gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre [...].

17.2.5 Komisioni, i ka kërkuar shpjegim subjekt të rivlerësimit, pasi: [...] duket se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë dhënë nga trupi gjykues me kryesues gjyqtarin Arbër Çela është dhënë në interpretim të gabuar të ligjit, duke deformuar rëndësinë e provave dhe lehtësimin e pozitës së njerit prej të pandehurve [...].

17.2.6 Për konstatimin e mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe, ndër të tjera, pretendon se vendimi ku kam qenë pjesë është marrë në përputhje të plotë me ligjin, nuk ka shkelje procedurale, asnjë favorizim të palëve në gjykim, asnjë shmangie nga praktika ime gjyqësore, edhe se, referuar praktikës së konsoliduar të Kolegjit, këto gjetje nuk mund të jenë objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit.

17.2.7 Për sa më lart, *Komisioneri Publik*, bazuar dhe në Rekomandimin⁴⁸ e ONM-së, datë 06.02.2023, vlerëson se çështja me palë të pandehurit ***.*** dhe ***.*** duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit sipas nenit 72, pika 2 të ligjit nr.96/2016, indikatori njohurive ligjore, konkretisht nëndikatori i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 380 në harmoni me nenin 362, pika 3 të Kodit të Procedurës Penale.

17.3 Vendim civil nr.*, datë **.3.2012, me kërkuar ***.*** (***), ku subjekti është gjyqtar i vetëm**

17.3.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër ka gjykuar kërkesën civile me objekt vërtetim i faktit juridik të vendndodhjes së pronës së ***.*** dhe përcaktimin e sipërfaqes së saj, me palë kërkuar ***.*** (***) dhe person i interesuar Këshilli i Qarkut Shkodër. Gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore janë bërë kërkesa të natyrës procedurale, ajo e kalimit procedural nga kërkuar ***.*** te ***.***, si dhe saktësimi i objektit të kërkesës së paraqitur, duke kërkuar përfundimisht korrigjimin e notës së transkriptimit të datës ** dhjetor 1930, vetëm për sa i përket sipërfaqes së paraqitur, bazuar ky kërkim në nenin 383/3 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo kërkesë u pranua nga Gjykata me vendim të ndërmjetëm.

17.3.2 Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. *** akti, datë **.3.2012, Gjykata ka vendosur: [...] Pranimin e kërkesës. Korrigjimin e notës së transkriptimit të datës ** dhjetor 1930 në favor të shtetasit ***.***, vetëm për sa i përket sipërfaqes së pronës së pretenduar, duke vendosur si sipërfaqe 1753⁴⁹ dynymë, siç rezulton nga akti i ekspertimit [...]. Ky vendim është ankimuar nga kërkuar ***.*** (***)

17.3.3 Gjykata e Apelit, Shkodër me vendimin nr.***⁵⁰, datë **.7.2012, për shkak të heqjes dorë nga kërkuar ***.*** ka vendosur: [...] prishjen e vendimit nr.***, datë **.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes që i përket kërkuar ***.*** (***) [.]

⁴⁷[...] e ka të ndaluar të marrë apo të përdorë prova që nuk janë marrë gjatë shqyrtimit gjyqësor [...] -shënim referues në të njëjtin vendim prg. pararendës.

⁴⁸ Shihni f.13 të aktit “Rekomandim i ONM-së”.

⁴⁹ Sipërfaqe në Notën e transkriptimit ishte 60 dynymë.

⁵⁰ Në dosje të Komisioni janë administruar faqet 1 dhe 3 të tij.

17.3.4 Komisioni i ka kërkuar shpjegim subjekt të rivlerësimit, pasi [...] duket se gjyqtari Arbër Çela ka trajtuar në mënyrë favorizuese palët në këtë proces gjyqësor, duke dhënë një vendim në interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit. Jepni shpjegime/qëndrimin tuaj duke dhënë argumentet ligjore lidhur me këto konstatime [...].

17.3.5 Për konstatimin e mësipërm, subjektit i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, ku ndër të tjera, ka pretenduar se kalimi procedural nga ***.*** te vajza e tij trashëgimtare ligjore është bërë nga gjykata në seancën përgatitore të datës **.3.2012 dhe lidhet me legjitimin substancial, të cilin ***.*** e ka pasur. Gjithashtu, edhe Gjykata e Apelit Shkodër, vënë në lëvizje nga ankimi i znj. ***.***, nuk ka vendosur mospranim ankimi, sikurse parashikon neni 450/1 i Kodit të Procedurës Civile, kur ankimi është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim, por ka vendosur, bazuar në nenin 201 të K. Pr. Civile heqjen dorë nga ankimi. Natyra e gjykimit të çështjes është një gjykim gracioz pa palë kundërshtare ndaj dhe nuk mund të shërbejë për të mënjeluar rrugën e zakonshme kontencioze të zgjidhjes së konfliktit.

17.3.6 Për sa më lart, *Komisioneri Publik*, bazuar dhe në Rekomandimin⁵¹ e ONM-së, datë 6.2.2023, në gjendjen që rezultojnë aktet, vlerëson se çështja me palë kërkuese ***.*** duhet të vlerësohet në kuadër të njohurive ligjore të subjektit sipas nenit 72, pika 2 të ligjit nr.96/2016, indikatorit i njohurive ligjore, konkretisht nënindikatorit i lidhur me aftësinë e përgjithshme për të interpretuar ligjin, përkatësisht nenin 388, paragrafi 3, i ndërlidhur me nenin 32, germa “c” e Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk rezulton se jemi para kushteve të domosdoshme për vërtetim gjyqësor të faktit, gjykimi *grazios*, pasi Nota e transkriptimit e datës ** dhjetor 1930, nuk ka humbur, nuk është zhdukur apo lind nevoja për t’u marrë në një rrugë tjetër sikurse edhe nuk është objekt *korrigjimi* apo *gabim* sipërfaqja nga 60 dynymë në aktin Notë Transkriptimi në 1753 dynymë në disponimin e vendimit gjyqësor.

18. Komisioneri Publik, në përfundim lidhur me këto gjetje, referuar *informacionit të organit ligjzbatues*, konstaton se rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016

IV.C Lidhur me gjetjen në vlerësimin e aftësive profesionale

19. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit, bazohet në aftësinë për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

20. Referuar burimeve dhe procedurës së përcaktuar nga ky kuadër ligjor, duke përfshirë në këtë vlerësim dosjet e administruara gjatë hetimit administrativ, denoncimin e fakteve nga publiku sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, si dhe Raportin e vlerësimit profesional të hartuar nga KLGJ, nga hetimi administrativ i Komisionit kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime.

⁵¹ Shihni f.13 të aktit “Rekomandim i ONM-së”.

21. Denoncimi i shtetases ***.***. (bashkim i dy denoncimeve)⁵²

21.1 Denoncuesja ngre pretendime se subjekti Arbër Çela, në shkelje të ligjit, ka vendosur në mënyrë të padrejtë pushimin e gjykimit për ankimin e shtetasit ***.*** ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ** të vitit 2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër. Nga vendimi rezulton se nga aktet e vëna në dispozicion, Komisionit, nga vetë subjekti, nga dosja gjyqësore,⁵³ janë administruar aktet që i përkasin çështjes penale, për të cilën është dhënë vendimi nr. **, datë **.12.2014, me kërkesë shtetasin ***.***, me objekt: “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.**, të vitit 2012, të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër”, parashikuar nga 329 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe akte që përkasin çështjes penale për të cilën është dhënë vendimi nr. **, datë **.2.2015, me kërkesë shtetasin ***.***, me objekt: “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.***, të vitit 2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër”,

21.2 Komisioni ka konstatuar se me vendimin nr. **, datë **.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër, subjekti ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. rregj. them.** datë **.1.2014, me kërkesë ***.***, me objekt: Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Gjykata e Apelit Shkodër⁵⁴ ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për shkak të shkeljeve procedurale që janë lejuar nga gjyqtari gjatë gjykimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, me trup tjetër gjyqësor.

21.3 Në vijim, subjekti në vitin 2015, me vendimin nr. **, datë **.2.2015, ka vendosur pushimin e gjykimit për çështjen penale me kërkesë shtetasin ***.***, me objekt: “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.***, të vitit 2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër”, parashikuar nga 291 i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.***, datë **.6.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për shkak të shkeljeve procedurale që janë lejuar nga gjyqtari gjatë gjykimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, me trup tjetër gjyqësor.

21.4 Komisioni vlerëson se, lidhur me vendimin nr. **, datë **.2.2015, ku subjekti ka disponuar për pushimin e çështjes ndaj ankimit të vendimit të mosfillimit penal nr.***/2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër, ai duhet të vijonte me shqyrtimin e kërkesës edhe pa praninë e shtetasit ***.*** dhe, në përfundim, të vendoste në mënyrë alternative atë që parashikon ligji procedural.

21.5 Në kuptim sa më sipër, Komisionit i ka rezultuar se: (i) Duket se gjyqtari Arbër Çela ka shqyrtuar dhe gjykuar këtë çështjen e vitit 2014, në kundërshtimin me përcaktimet e nenit 18 të Kodit të Procedurës Penale, duke vijuar me kryerjen e veprimeve procedurale, në kushtet kur kjo çështje duhet të ishte pezulluar; (ii) Duket se gjyqtari Arbër Çela ka pushuar çështjen e vitit 2015 në kundërshtim me përcaktimet e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos iu përgjigjur objektit të kërimit, si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në pjesën urdhëruese; (iii) Duket se gjyqtari Arbër Çela në gjykimin e këtyre dy çështjeve ka vepruar në kundërshtim me ligjin procedural, duke cenuar dhe mohuar të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor, parim i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

21.6 Për konstatimet e mësipërme i ka kërkuar shpjegime subjektit, i cili ka pretenduar se vendimmarrja e tij ka qenë në përputhje me rregullat procedurale penale, praktikën e Gjykatës së Lartë dhe praktikën e përditshme gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, Shkodër dhe gjykatave të tjera të vendit. Në asnjë moment nuk rezulton se janë cenuar dhe mohuar të drejtat

⁵² Ankesë e shtetasit ***.*** protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.7.2018; Ankesë nga web e shtetasit ***.***, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **.2.2019. *Shihni f. 45-48 të vendimit të Komisionit.*

⁵³ Aktet bashkëlidhur denoncimit nr. *** prot., datë **.7.2018, të shtetasit ***.***.

⁵⁴ Me vendimin nr. **, datë **.4.2015.

e palëve për një proces të rregullt ligjor, për sa kohë kjo e fundit (kërkuesi) vetë ka humbur interesin për çështjen, duke mos u paraqitur në gjykim.

21.7 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se sipas vërtetimit nr.*** prot., datë **.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se ankesa nr. *** prot., datë **.9.2014, me ankues ***.***, është dërguar për trajtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

